


01-DU3



Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 12 të Udhëzim Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-67135/24 dt. 24.05.2024, të pronarëve Cenë Krasniqi, dhe Naim Murati nga Prishtina dhe investitorit “AAC Group” sh.p.k. me adresë në lagjen Kodra e Diellit, rr. Major M. Bushi, nr 4/9, Komuna Prishtinë, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesën shumë banesore me afarizëm, me etazhitet B+S+P+5ET, ndërtuar në Lagjen “Mati 1”, në rrugën “Shaqir Igrishta” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 26.05.2025, lëshon këtë:

C E R T I F I K A T Ë E P Ë R D O R I M I T

I. I LEJOHET pronarëve Cenë Krasniqi dhe Naim Murati nga Prishtina dhe investitorit “AAC Group” sh.p.k. me adresë në lagjen Kodra e Diellit, rr. Major M. Bushi, nr 4/9, Komuna Prishtinë, me certifikatë të regjistrimit ARBK 810824046, me përfaqësues Hajredin Ferataj, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-67135/24 dt. 24.05.2025, përdorimi i ndërtesës shumë banesore me afarizëm, me etazhitet B+S+P+5ET, e ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351-42734 dt. 09.07.2013, në kuadër të bllokut urban “A-17”, të tërësisë “A”, të Planit Rregullues “Mati 1” në Prishtinë konkretisht në parcelën kadastrale nr. 1863-0, ZK Matiçan.

II. Ndërtesa nga pika I. e këtij vendimi, ndodhet në rrugën “Shaqir Igrishta” ku ka dalje hyrjet kjo ndërtesë me numër: 53, 55, 57, 59 dhe 61, në Prishtinë, dhe të njëjtat do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

III. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesës dhe njësive të saja në evidencat e regjistrit kadastral.

A r s y e t i m

Pronarët Cenë Krasniqi dhe Naim Murati nga Prishtina dhe investitorit “AAC Group” sh.p.k. me certifikatë të regjistrimit ARBK 810824046, me përfaqësues Hajredin Ferataj, me kërkesën me 05 Nr. 391/02-67135/24 dt. 24.05.2024, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesën shumë banesore me afarizëm, me etazhitet B+S+P+5ET, të ndërtuar në kuadër të bllokut urban “A-17”, të tërësisë “A”, të Planit Rregullues “Mati 1” në Prishtinë konkretisht në parcelën kadastrale nr. 1863-0, ZK Matiçan, ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore Ndërtimore 05 Nr. 351-42734 dt. 09.07.2013, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkuessit kanë prezantuar dokumentacionin; Fotografi gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të ndërtesës, nga udhëheqësi i punishtes Hysni Krasniqi; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikëqyrësi Rita Arapi; Raportin e përfundimit të punëve të

konstruksionit, nga mbikëqyrësi Feti Selmani; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikëqyrësi Burim Dula; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektrike, nga mbikëqyrësi Asmir Hamdi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikëqyrësi Vedat Jeniçaku; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga kompania e licencuar për kryerjen e matjeve kadastrale “NEËS”Sh.p.k. me nr. të licencës 22;

Me shkresat zyrtare “Pëlqim për ndërrim të llojit të shfrytëzimit të parcelave nr. 667-17 dhe 666-19, ZK. Matiçan” dhe “Pëlqim për bashkim të parcelave kadastrale nr. 667-17 dhe 666-19, ZK Matiçan” të datës 29.08.2024 është obliguar pala që ta kryej ndërrimin e llojit të shfrytëzimit dhe bashkimin e parcelave të lartë cekura, i cili me pas me ka prezantuar Certifikatën e pronës me nr. 1863-0, (si rezultat i bashkimit të parcelave 667-17 dhe 666-19) ZK. Matiçan, me lloj të shfrytëzimit tokë ndërtimore.

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Komisionit profesional të pranimit teknik, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumë banesore me afarizëm mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim nr. 04/L-110, janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezantuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesa shumë banesore me afarizëm mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesën shumë banesore me afarizëm.


Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certifikatë, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-së

Ky vendim u printua në 6 (gjashtë) kopje identike dhe i dërgohet: Kërkuesve/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT DHE MJEDISIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-67135/24 DT. 26.05.2025**

Zyrtari,
Berim Osmanaj



Udhëheqëse e Sektorit,
Nazife Krasniqi